



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2022:147390  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05554798

**E.nr.688//23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditores A.J., të cilët i përfaqëson av Arlinda Haziri nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e të ardhurave personale, si dhe shpenzimet e procedurës, më datë 03.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën **E.nr.688/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.688/23, të datës 15.05.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e të ardhurave personale si dhe shpenzimet e procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:147391, të datës 13.09.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 14.07.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 6,864.36 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.688/23, më datë 08.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**